



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 20
Prishtinë, më 02 tetor 2013, në orën 10:00, salla S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Imri Ahmeti, Adem Grabovci, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Bali Muharremaj.

Të ftuar: Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministër dhe Ministër i Drejtësisë dhe Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica zyrtar i fushës në Komision dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 25.09.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 25.09.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 25 shtator 2013.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012

Kryetari – Tha se opinionin e auditimit për vitin 2012 për Ministrinë e Drejtësisë (MD) është opinion i pakualifikuar, me theksim të çështjes, kjo për shkak se informacionet në shpalosjen e pasurisë nuk ishin të plota dhe të sakta. Për vitin 2011 ZAP kishte dhënë 12 rekomandime për MD, prej tyre 4 janë adresuar plotësisht, 6 janë në proces të adresimit, ndërsa 2 nuk janë adresuar fare. MD për vitin 2012 ka shpenzuar 16.2 milionë euro ose 87% e buxhetit në total nga ndarja buxhetore prej 18.6 milionë euro. Ngecja më e madhe është në kategorinë e shpenzimeve kapitale, ku nga buxheti i ndarë prej 2.0 milionë euro janë shpenzuar 1.1 milion euro, ose shprehur në përqindje 57%, dhe se mbi 40% e tyre ishin shpenzuar në tremujorin e fundit të vitit. Shuma e mjeteve të mbledhura për vitin 2012 nga të hyrat vetanake ishte 50.417 euro (të hyrat nga konfiskimet 29.926 euro të hyrat për provimin e Jurisprudencës dhe noterisë 19.975 euro), si dhe shitjet e tjera 516 euro. Shpenzimet e udhëtimit jo në përputhje me kushtet e përcaktuara. MD-ja për shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit ka shfrytëzuar kontratën e Ministrisë së Financave për furnizim me bileta të udhëtimit. Sipas kësaj kontrate, nëse çmimet ndryshojnë, atëherë duhet të merren për bazë çmimet e tregut, mirëpo në këtë rast duhet të arrihet marrëveshje paraprake. Gjatë testimit të një pagesë për shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit në vlerë prej 6.352€, kemi vërejtur që çmimet nuk janë në përputhje me ato të kontraktuara. Për këtë, MD nuk kishte arritur asnjë marrëveshje paraprake. Përveç kontratës me MF, ka shfrytëzuar edhe kontratën e Zyrës së Kryeministrit. Procedimi i pagesës 4.982€ është bërë duke u bazuar vetëm në çmimet e përshkruara në faturë, të cilat pa dëshmitë e bashkëngjitura nuk sigurojnë se janë çmime reale, e në të njëjtën kohë nuk siguron se ky shpenzim është bërë në mënyrë të rregullt. Menaxhim jo i mirë i automjeteve në rastet e aksidenteve. Në bazë të UA 03/2008 për përdorimin e automjeteve zyrtare, në raste aksidentesh automjetet nuk duhet të dërgohen në servis pa kontrollin paraprak të zyrtarit kompetent të njësies së transportit dhe kompanisë së sigurimit në të cilën është siguruar automjeti. Më tutje, citohet që drejtuesi i automjetit, ndal automjetin dhe qëndron në vendin e aksidentit deri në arritjen e autoriteteve policore, ose në kryerjen e të gjitha procedurave të përcaktuara me këtë UA. Automjeti me targa 3Z-125-05 ka pësuar aksident më 18 qershor 2012. Dëmtimet e automjetit janë riparuar nga MD-ja. Lidhur me aksidentin nuk ka një raport nga autoritetet kompetente të policisë ose të kompanisë së sigurimit. Vlera e riparimit për këtë automjet ishte 1.668€. MD ka drejtorin e Auditimit dhe dy auditorë të brendshëm, ka Njësinë e Auditimit e cila kishte përgatitur planin e auditimit. Po ashtu MD ka komitetin e Auditimit i cili gjatë vitit 2012 ka mbajtur takime të rregullta. Në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2012, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kishte planifikuar 7 (shtatë) auditime. Këtë përcaktim e kishte bërë në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioritetëve, duke e orientuar auditimin në disa fusha të ndryshme. Auditori i brendshëm brenda vitit 2012 kishte kryer 7 (shtatë) auditime. Prej tyre, 6 (gjashtë) auditime përfshihen në planin vjetor të vitit 2012, ndërsa një auditim ishte me kërkesë të menaxhmentit. NJAB kishte bërë një punë të mirë dhe kishte ndihmuar menaxhmentin në vlerësimin e përshtatshmërisë së kontrolleve. Në këto raporte NJAB kishte dhënë rekomandime të qarta se si menaxhmenti të përmirësoj menaxhimin dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm. Komiteti i auditimit kishte mbajtur 4 (katër) takime të rregullta dhe kishte shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NJAB-it. Prej gjithsej 44 rekomandimeve të dhëna nga AB, 24 prej tyre janë adresuar, 13 janë në proces të adresimit, ndërsa 7 (shtatë) prej tyre nuk janë adresuar.

Ramiz Lladrovci – Prezantimi i drejtë i pasqyrave financiare është bërë nga ana e Ministrisë

së Drejtësisë, në përjashtim të trajtimit të pasurisë, për çka ZAP ka dhënë edhe theksimin e çështjes. Konkluzioni i përgjithshëm është se menaxhmenti i MD- së ka bërë hapa pozitiv në menaxhimin financiar. Fusha e prokurimit publik njihet si fusha me rrezik të lartë, mirëpo kjo në MD është vlerësuar mirë. MD në fund të vitin 2011 kishte menaxhim të mirë të borxheve, kjo vërehet edhe në raportin e auditimit. Planifikimi i buxhetit kapital ka ngecje, mirëpo projektet e mëdha kapitale të MD- së, tani janë të transferuara në MAP për menaxhim. Përgëzoj Ministrinë e Drejtësisë për punën e mirë që ka bërë në këtë ministri.

Mursel Halilji – Ishte i mendimit se të gjeturat e ZAP-it në raportin e auditimit në MD nuk paraqesin shkelje të mëdha, si bije fjala në menaxhimin e parave të të burgosurve. Vërejtjet janë dhënë në regjistrim të pasurisë. Në këtë sistem janë evidentuar vetëm pasuritë nga viti 2011 e tutje. Pasuritë e blera para vitit 2011 nuk janë të përfshira në këtë sistem, si dhe nuk janë prezantuar në PVF e saj. Përpos kësaj edhe blerje të vitit 2012 nuk janë evidentuar në sistemin E – pasuria. Projektet kapitale nuk janë realizuar sipas dinamikës, mirëpo këtu bëhet fjalë për projekte të vogla kapitale që kjo ministri ka nën menaxhim.

Afrim Hoti – *Mungesa e akteve të emërimit për të punësuarit* - ZAP ka vërejtur se kontratat ende nuk ishin zëvendësuar në akte të emërimit edhe pse kishin dy vlerësime të mira vjetore. Megjithatë, në fillim të vitit 2013 MD ka filluar të zëvendësojë të gjitha kontratat me akte të emërimit. Si është situata tani në fund - mbyllje të vitit 2013? *Mos azhurnimi i dosjeve të personelit* – nga 21 dosje të testuara, në tetë prej tyre, ZAP ka vërejtur që vlerësimet vjetore të punës nuk ishin bërë. Pas konsultimeve me burimet njerëzore, këta të fundit kanë arritur të na sigurojnë vlerësimet vetëm për tre punonjës. Çka ka ndërmarrë menaxhmenti i MD- së ndaj zyrtareve të vetë për shkak të mos azhurnimit të dosjes së personelit?

Imri Ahmeti – Tha se të gjeturat brenda këtij raporti nuk duhet t'i japin komoditet ministrit të MD- së për vetëkënaqësi, përkundër asaj se ka disa përparime në fushën e menaxhimit financiar të MD. Bie fjala realizim jo i mirë i planit të prokurimit, lidhet me shpenzimin e ulët të buxhetit kapital. *Pastaj, planifikim jo i mirë i shpenzimeve* - është planifikuar që të blihen pajisje të ndryshme të teknologjisë informative, ndërsa është blerë makinë fotokopjimi. Prandaj, këto të gjetura kërkojnë përkushtim nga menaxhmenti i MD-së.

Valbona Dibra – Theksoi se raporti është i rregullsisë dhe ZAP-i ka dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, që do të thotë se pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë. Janë disa të gjetura të vogla. Siç shihet në faqen 16 të raportit MD-ja disa çështje i ka adresuar edhe në prokurori, dëshmi kjo që tregon për përkushtimin e Ministrit të Drejtësisë për adresimin e çështjeve. Nëse shikohet në konkluzionet e përgjithshme të raportit të ZAP-it për MD-në në faqe 27, del se është bërë progres në fushën e menaxhimit financiar, si dhe në fushën e prokurimit. Përgëzoj ministrin për punën e mirë që ka bërë në këtë ministri.

Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministër dhe ministër - Nuk jemi të kënaqur me pozicionin që kemi, por jam i bindur që në MD nuk ka lëshime kur ka shkelje. Vendimet e OSHP-së janë vendime të gjykatës dhe si të tilla ne i zbatojmë. MD ka pasur 18 milionë, ka shpenzuar rreth 16 milionë. Arsyeja e mos shfrytëzimit është se më mirë të dalë në suficit, sesa që paraja publike të shpenzohet pa arsye. Investimet kapitale i kemi bartur në MAP, ndërsa ne i kemi mbajtur vetëm ato që kanë pasur të bëjnë me renovimin e ndonjë pavijoni ose me vetura për bartjen e të burgosurve. Por, duhet t'ju informoj se për tre vjet asnjë veturë nuk është blerë për nevojat e ministrisë. Në MD veturat kanë GPS dhe vetura lejohen për përdorim 24 orë, vetëm për drejtorët e burgjeve. *Rasti i aksidentit me veturë zyrtare*- personi në fjalë nuk punon më në MD dhe unë do të provoj të përdorë procedurat që ai ta paguaj vetë. *Mjetet vetanake* - kemi bërë përmirësim të dukshëm. Sa i përket mjeteve të burgosurve kam gjetur një menaxhim jo të mirë, por tani situata është përmirësuar dukshëm. Pastaj, shpërndarja e të hyrave nga provimi

jurisprudencës - kemi një UA dhe tani shpërndarja bëhet në mënyrë adekuate. Te shpenzimet kapitale - kanë qenë 2 milionë dhe janë shpenzuar rreth 1 milion euro. Kemi pasur raste të renovimit të dy pavijoneve dhe nuk kemi mundur t'i lëvizim të burgosurit. Blerja e disa veturave – në këtë rast veturat të cilat janë sjellë nga OE, jo sipas kritereve të parapara në tender dhe si të tilla nuk i kemi pranuar. *Obligimet e bartura dhe komiteti i auditimit* – komiteti i auditimit është “pak komod”, ndërsa auditori i brendshëm po e kryen punën mirë. Auditori i brendshëm është ngarkuar me punën shtesë - ku asnjë kontratë nuk nënshkruhet në MD pa mendimin e auditorit të brendshëm, kjo me qëllim të preventivës së gabimeve. *Raportet javore* - çdo të premte në orën 16:00 janë të publikuara shpenzimet e sakta. *Mos regjistrimi i pasurisë* – ka probleme me regjistrimin e pasurisë të vitit 2011. Sistemi e – pasuria, nuk po i pranon këto të dhëna. Problemi ka ndodhur në shërbimin korrektues - kur ka regjistruar një makinë në vend të 42 mijë i është shtuar një zero dhe lidhur me këtë jeni të njoftuar. Shërbimi korrektues dhe provues me ligjin e ri janë agjenci të pavarura. *Çështja e udhëtimeve* - kam tentuar që të shfrytëzohet kontrata ekzistuese në mënyrë që të mos ketë shumë kontrata. Kjo me arsyetimin që me një aeroplan çmimi i biletave është i ndryshëm, kam kërkuar që kjo të ndërpritet. Ne duhet të krijojmë një ambient që agjencitë institucionale të kenë të njëjtin çmim. MD ka zbritur subvencionet në 20 mijë. *Aktet e emërimit*- janë kryer. Kanë qenë dy pengesa: njëri rast ka qenë rasti i verifikimit të zyrtarëve në agjencinë e inteligjencës dhe në këtë rast ata të cilët nuk kanë kaluar verifikimin, nuk mund të ushtrojnë pozitën përgjegjëse. Të njëjtit nuk janë larguar nga puna, por nuk mund të punojnë në pozitën ku është kërkuar kalimi i testit të verifikimit. Rasti i dytë është rasti i të punësuarve me shkollë të mesme ndërsa përshkrimi i vendit të punës është me kualifikim superior. Atëherë në këto rast nuk plotësohen kushtet për akt emërim. MAP ka menduar që këtyre punëtorëve t'ju jepet një afat trevjeçar, pas kësaj kohë ata ose duhet të zëvendësohen ose duhet t'ju jepen aktet e emërimit. Plani i prokurimit këtë vit është shumë i saktë dhe për të gjitha mjetet mbi 1000 euro janë –planifikuar saktë si investime kapitale. *Shpenzimi në tremujorin e fundit* - nuk është praktikë e mirë, por duhet t'ju informoj se tri herë është anuluar konkursi për drejtor të prokurimit, por nuk ka pasur kandidat. Nëse ka lëshime në prokurim atëherë Drejtori i prokurimit duhet të shkojë. Ftoi ZAP-in që të shikoj me llupë punën në MD. Rekomandimet e dala do të adresohen saktë.

Bedri Bahtiri, sekretar i Ministrisë së Drejtësisë – *Çështja e biletave* - MD ka për obligim çështjen e ekstradimeve dhe këto raste janë raste të emergjencave. Çështja e fotokopjes ka tejkaluar shumë dhe si e tillë ka qenë kapitale dhe për shkak të kësaj nuk është lidhur një kontratë e tillë. Në projektin e mjekësisë ligjore kemi insistuar që për bartje të kufomave të kontraktohet një kompani private dhe në rastin e tillë nuk ka pasur kompani të përgjegjshme. Sa i përket akteve të emërimit - kemi kërkuar sqarime nga MAP-i dhe tani janë lëshuar akt emërimet, por me një fusnotë sipas të cilit ata duhet të përmbushin detyrimin sipas ligjit. Çështja e regjistrimit të pasurisë tashmë është adresuar, ka pasur gabim teknik dhe tani mirëpresim auditivin për këtë vit. Sa i përket të gjeturës lidhur me aksidentin e një veture-fjala është për paditurinë e atij zyrtari lidhur me atë çështje. Pastaj, mungesa e raportit të policisë po paraqet probleme dhe me kompanitë e sigurimeve.

Imri Ahemti -*Çështja e verifikimit të zyrtarëve*- nuk e di nëse ka vlejtur parimi i prezumimit të pafajësisë, në këto raste. Me ligj është afati i ankesës për mos kalim të verifikimit. Është problem ligjor, sepse “vetëm pse ndaj dikujt është iniciuar procedura, pa vendim meritore të gjykatës nuk i jepet verifikimi” kjo nuk është në rregull. Ky duhet të iniciohet si proces i rirregullimit ligjor, sepse duket që ka padrejtësi në këto raste.

Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministër dhe ministër – Lidhur me verifikimin e zyrtarëve tha se ka themeluar komisionin se kush duhet të kalojë verifikimin. Pas përgjigjes ligji parasheh afatin e ankesës. Ne kemi ruajtur koeficientin dhe nivelin e pagës, por nuk mund të ruaj pozitën për të cilën parashihet kalimi i verifikimit. Shkalla e parë është verifikimi shkalla e dytë është shefi i agjencisë. Ne kemi vepruar sipas ligjit. Pajtohem që ligji duhet të plotësohet dhe

ndryshohet, sepse nuk është në rregull që vartësit e mi të verifikohen, ndërsa unë jo. Pastaj, dy shkallëshmëria nuk duhet të jetë brenda një institucioni. Ndoshta duhet të bëhet një komision i përbashkët si shkallë e dytë. Megjithatë verifikimi për disa përgjegjësi duhet të bëhet.

Artan Venhari- zëvendësauditor - Theksi i çështjes për MD ka ndodhur për shkak të gabimit teknik. Fokusi i veçantë i MD duhet të jetë planifikimi i saktë dhe ekzekutimi i buxhetit. Ka përmirësim, megjithatë paraqitja në baza mujore e obligimeve do të na gëzonte.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Ministria e Drejtësisë, të dorëzojë planin e veprimit lidhur me adresimin e rekomandimeve të ZAP-it, si dhe të Auditorit të brendshëm, lidhur me identifikimin e obligimeve dhe pagesat e tyre sipas muajve.
2. Plani i veprimit duhet të dorëzohet në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në afatin prej një muaji.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu